



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës - Ministarstvo Inostranih Poslova i Diaspore
Ministry of Foreign Affairs and Diaspora

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës shpall:

Konkurs

Lëvizje brenda kategorisë

Të drejtë për aplikim në këtë procedure kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.

Titulli i pozitës së punës	Zyrtar i misionit diplomatik
Klasa e pozitës	Profesional 2
Koeficienti/Paga	7
Nr. i kërkuar	2
Data e njoftimit	20/12/2022
Afati për aplikim	04/01/2023 - 13/01/2023
Institucioni	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
Departamenti	MISONET
Divizioni	
Vendi i punës	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
Nr. i Referencës	RN00010598
Kodi	RPC0004268



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

Detyra: 1 Mban përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e veprimeve gjatë kryerjes së detyrës;

Detyra: 2. Mbron interesat e shtetit të Kosovës dhe të shtetasve dhe personave juridik të Republikës së Kosovës në shtetin ose shtetin ku është akredituar dhe ushtron funksionet e tij;

Detyra: 3. Zbaton Rregullat për informacionin e klasifikuar edhe pas largimit nga Ministria e Punëve të Jashtme, si dhe siguron ruajtjen e të dhënave dhe informatave që iu janë besuar;

Detyra: 4. Të pezullojë aktivitetin e tij në një parti, organizatë ose shoqatë politike gjatë periudhës në shërbimin e jashtëm;

Detyra: 5. Të mbaj në të gjitha rrethanat një qëndrim moral të denjë dhe profesional;

Detyra: 6. Të mos bëjë deklarata që bien në kundërshtim me qëndrimin e Republikës së Kosovës në marrëdhënie me shtete tjera ose organizata ndërkombëtare;

Detyra: 7. Të respektoj ligjet dhe rregulloret e shtetit ose të shteteve ku është akredituar dhe të mos përfshihet në veprimtari, të cilat mund të vlerësohen si ndërhyrje në punët e brendshme të shtetit ose të shteteve ku zhvillon veprimtarinë;

Detyra: 8. Të ushtron veprimtarinë e vet, në përputhje me imunitetet dhe privilegjet që gëzon si anëtar i misionit diplomatik;

Detyra: 9. Të mos ushroj në shtetin ose shtetet ku është akredituar veprimtari tregtare ose çdo veprimtari tjetër fitimprurëse për llogari të tij ose të familjes së tij.

Detyra: 10. Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.
- Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.



3. Kërkesat e përgjithshme formale

a) Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to në: shkenca politike, marrëdhënie ndërkombëtare, diplomaci, histori, sociologji, filozofi, juridik, studime evropiane, ekonomi ose arte.

b) Kualifikime të posaçme formale:

Njohja e gjuhës ITALIANE në nivelin C1-C2 (e obliguar).

Njohja e gjuhës ITALIANE, dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime universitare të kryera në këtë gjuhë.

c) Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;

- *Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;*
- *Njohuri të mira metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike dhe në marrjen e vendimeve*
- *Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;*
- *Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;*
- *Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;*
- *Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar*



11. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

- Njohja e gjuhës ITALIANE në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e gjuhës ITALIANE dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime universitare të kryera në këtë gjuhë;
- Pas përfundimit të procedurës së konkursit, kandidatët e përzgjedhur sistemohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, deri në plotësimin e kushteve formale për dërgimin e tyre në misione

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

